

NJOFTIM PER VEND TE LIRE PUNE

Intesa Sanpaolo Bank Albania kërkon të punësojë personel në pozicionin:
Agjent për Call Center - Tiranë

Përgjegjësite kryesore:

Të përmbushë shërbimet dhe objektivat e bankës ndaj klientëve. Të përmbushë kërkesat e klientëve për shërbimet e ofruara nga Call Center, të merret me ankesat e klientëve dhe kërkesat e tjera, të delegojë dhe / ose të bashkëpunojë me departamentet e tjera përkatëse për secilin produkt / shërbim. Ka përgjegjësinë të kontaktojë klientët për të mbledhur pagesat e prapambetura.

Kërkesat / aftësitë:

Aftësi shumë të mira të komunikimit me shkrim dhe me gojë; ndjenjë të lartë përgjegjësie

- I vëmendshëm në detaje, me qëllime të përcaktuara
- Të jetë i gatshëm të punojë në grup dhe me turne
- T'ju përgjigjet telefonatave, në përputhshmëri me treguesit kryesorë të performancës.
- T'i ofrojë klientit pikat e forta dhe më të mira të produktit
- Të jetë i orientuar drejt klientit duke e vënë atë në qendër të vëmendjes gjatë bisedës
- Të dëgjojë me kujdes reagimet e klientëve
- Angazhim maksimal për t'i ofruar klientit shërbim të shkëlqyer
- Aftësi për të punuar i/e pavarur dhe për t'iu përshtatur një mjedisi në ndryshim.
- I gatshëm për të ndihmuar kolegët e tjerë të ekipit për çështje të përditshme dhe / kur janë në vështirësi.
- Të përdorë me shpejtësi dhe efikasitet programet dhe telefonin në të njëjtën kohë

Kërkesat:

- Diplomë Universiteti
- Aftësi të shkëlqyera komunikimi (zë i këndshëm, i qartë dhe mënyrë e saktë në të shprehur)
- Aftësi në ndërtimin dhe ruajtjen e marrëdhënieve të mira me të tjerët
- Të jetë i motivuar dhe të ketë dëshirë për të punuar në ekip (shpirti i ekipit)
- I gatshëm për të punuar me orë të zgjatura, në fundjavë si dhe nën presion
- Njohuri shumë të mira në programet bazë të kompjuterit (Office)
- I rrjedhshëm në anglisht dhe italisht
- **Përvoja e preferuar:** Të ketë eksperiencë të ngjashme pune në ekip

Kandidatët duhet të dorëzojnë:

- Letër interesi dhe një Curriculum Vitae së bashku me një foto të kohëve të fundit (në gjuhën angleze)
- Lista e notave gjatë viteve të studimeve Universitare
- Diplomën Universitare

Aplikimet duhet të dorëzohen jo më vonë se **data 17 Qershor 2018**.

Dhe duhet të adresohen tek: Intesa Sanpaolo Bank Albania
Departamenti i Burimeve Njerëzore
Rruga: Ismail Qemali, Nr.27, Tiranë
E-mail: hr@intesasanpaolobank.al